

RREGULLORJA E NISMËS SË EMËRUAR "MyGNV"

Subjekti promovues

Grandi Navi Veloci S.p.A. (më poshtë "GNV") me seli ligjore në Calata Maraini d'Italia - 90146 Palermo dhe me zyra në Via Balleydier 7 - 16149 Genova, kodi fiskal dhe tarifa e vlerës së shtuar 13217910150, e regjistruar në Dhomën Tregtare të Palermo R.E.A. 268303.

Tipologjia dhe emërimi

Nismë tregtare e emëruar "MyGNV" (më poshtë "Nisma").
Deklarohet që në bazë të nenit 6, paragrafi 1, shkronja C-bis i D.P.R. n. 430/2001, nuk konsiderohen operacione me çmim "manifestimet në të cilat, përballë një shpenzimi të caktuar, me ose pa një kufi hyrje, çmimet janë të përbërë nga kuponë për t'u përdorur mbi një shpenzim të mëtejshëm në të njëjtën pikë shitje që ka lëshuar këtë kuponë ose në një pikë tjetër shitje që bën pjesë e të njëjtës markë tregtare ose sipërmarrje".

Zona

Nisma do të zhvillohet në territorin italian.

Kohëzgjatja

Nisma do të ketë vlefshmëri nga data 1 maj 2022 deri në 30 prill 2023 (më poshtë Kohëzgjatja).
Kuponët për shpenzim mund të kërkohen dhe përdoren brenda datës 30 prill 2025.
Shtytje të mundshme kohore do të komunikohen menjëherë dhe në mënyrë të detajuar.

Qëllimi

Nisma është e finalizuar për të nxitur shërbimin e biletarisë së Trageteve GNV duke shpërblyer besnikërinë e klientëve.

Përfituesit

Nisma u drejtohet të gjithë konsumatorëve përfundimtarë, personave fizik, klientëve të GNV dhe të regjistruar në fidelity card MyGNCV (më poshtë veç e veç "Pjesëmarrësi" ose në mënyrë kolektive "Pjesëmarrësit").
Përfshihen nga Nisma të gjithë personat juridik, subjektet në posedim të Tarifës së Vlerës së Shtuar, operatorët profesional, ri-shitësit dhe, në përgjithësi, të gjithë subjektet që nuk hyjnë në përkufizimin e Pjesëmarrësve.

Mënyra i pjesëmarrjes

GNV organizon Nismën e pranishme që shpërblen Pjesëmarrësit me dhënien e kuponëve për shpenzim të përbërë nga zbritjet GNV, si tregohet në tabelën e sjellë më poshtë.

Kuponët për shpenzim mund të merren me blerjen në biletari të Trageteve GNV në arritjen e pikëve të renditura në tabelën e sjellë më poshtë.

Në veçanti, për të marrë pjesë në Nismën e mësipërme është e nevojshme të jeni të regjistruar ose të regjistrohëni në fidelity card MyGNV: regjistrimi është falas dhe kryhet lirisht nga çdo Pjesëmarrës nëpërmjet seksionit të posaçëm në faqen www.gnv.it.

Pasi të keni përfunduar saktësisht regjistrimin, dhe të keni kryer login e parë, Pjesëmarrësit do t'i komunikohet nëpërmjet mail një kod pjesëmarrje që e identifikon në program dhe i lejon, në rast të çdo blerje, të transformojë vlerën e blerjes në pikë krediti që, herë pas here, të mbledhura japin mundësinë e arritjes së kuponëve për shpenzim të parashikuar.

Në çdo moment, gjatë Kohëzgjatjes, Pjesëmarrësit mund të hyjnë nëpërmjet internetit në një seksion të web brenda faqes www.gnv.it, në të cilin mund të konsultojnë: Rregulloren e Nismës, pikët e gjeneruara nga blerja e biletarisë, ndryshimin e të dhënave të tyre, dhe eliminimin nga

Nisma.

Është detyrë e Pjesëmarrësve të veçantë të sinjalizojnë, brenda një kohe maksimale prej 30 ditësh nga data e kryerjes së udhëtimit, i gabimeve të mundshme të kreditimit të pikëve edhe për shkak të një caktimi të gabuar të kodit personal.

Mënyra e mbledhjes së pikëve

Për të mbledhur pikët është e nevojshme që Pjesëmarrësit të kërkojnë, në momentin e blerjes së titullit të udhëtimit shoqërimin e biletës GNV me kodin e pjesëmarrjes në posedim të tyre.

Vlera e mbledhur do të njihet mbi bazën e vlerës së paguar dhe vetëm në rastin në të cilin shërbimi i blerë do të jetë përdorur.

Kreditimi efektiv i pikëve do të kryhet pra pasi të jetë kryer udhëtimi.

Përjashtohen nga regjimi i mbledhjes së pikëve titulli i udhëtimeve të strukturuar si opsione dhe para-blerje. Vlera e biletës do të kthehet në pikë sipas raportit që vijon:

➤ 1 pikë e barabartë me 10 euro të biletarisë së blerë.

Do të jetë e mundshme të shoqëroni pikët mbi kodin e pjesëmarrjes njëkohësisht me datën e emetimit të biletës nëpërmjet të gjitha kanaleve.

Do të jetë e mundur, gjithashtu, të shoqëroni pikët e mëtejshme ndaj kësaj date dhe brenda 30 ditësh nga data e udhëtimit, ekskluzivisht nëpërmjet zonës së rezervuar My Gnv (mygnv.gnv.it)

Mbledhja efektive e pikëve do të kryhet vetëm me përfundimin e udhëtimit pra në rast anulimi të biletës ose në mungesë të përdorimit nuk do të mbledhet asnjë pikë.

Kuponët për shpenzim mund të kërkojnë vetëm në rast se arrihet një nga kufijtë e parashikuar.

Që biletat të mund të konsiderohen të vlefshme duhet të kenë si mbajtës pronarin e kartës MyGnv.

Kreditet në pikë do të jepen kodit të posaçëm të pjesëmarrjes dhe do të llogariten duke u bazuar mbi shpenzimin e kryer në neto nga mbledhje të mundshme të kuponëve për blerje nga Pjesëmarrësi, ulje, shlyerje, etj.

Një person i vetëm nuk mund të marrë pjesë me më shumë kode, gjithashtu, pikët e fituara nëpërmjet shoqërimit të kodit të pjesëmarrjes në titullin e udhëtimit, janë personale dhe nuk do të mund të shkëmbehen ose transferohen midis subjekteve të ndryshëm.

Për të lejuar realizimin e Nismës do të aktivizohet nga GNV një sistem i posaçëm informatikë që kryen llogaritjen e blerjeve të biletarisë të kryera me kodin e pjesëmarrjes dhe me azhurnimin e pikëve në rast të mbledhjes së kuponëve për blerje.

Për të arritur përfitimet e programit është e nevojshme që personat që kanë të drejtë të ruajnë dhe të paraqesin kur kërkohet, origjinalin e biletave të blera dhe të përdorura.

GNV ruan mundësinë të vendosë, gjatë nismës së pranishme, aktivitete të tjera të mundshme promovuese me qëllim lehtësimin e pjesëmarrësve. Në veçanti, mund të parashikohen zgjatje të Nismës, kuponë për shpenzime plotësuese ose kushte më të favorshme për Pjesëmarrësit.

Në përgjithësi, këto kushte do t'u komunikohen pjesëmarrësve nëpërmjet materialit promovues i vendosur në dispozicion nga GNV në faqen www.gnv.it dhe në seksionin web privat i rezervuar ndaj çdo Pjesëmarrësi.

Kërkesa e kuponëve për shpenzim

Me arritjen e kufirit të vendosur për pikët të parashikuar për fitimin e kuponëve për shpenzim, Pjesëmarrësi mund të kërkojë kuponin për shpenzim, i përbërë në një ulje si parashikohet në tabelën më poshtë.

Në vijim të kërkesës GNV do të aktivizohet në kryerjen e kontrolleve mbi saktësinë e biletave që kanë gjeneruar këtë kredit.

Kuponët për shpenzim do të jepen nëpërmjet një kodi brenda zonës personale të posaçme ose nëpërmjet Contact Center.

Kuponët për shpenzim duhet të kërkojnë me një kërkesë të parakohshme prej 5 ditësh pune para

datës së nisjes. Për çdo lloj informacioni tjetër mund të shkruajmë me mail në adresën e mëposhtme: mygnv@gnv.it.

Kuponët për shpenzim mund të merren nga personat që fitojnë këtë të drejtë në momentin e arritjes së pikëve të parashikuara për kufirin e interesuar dhe mund të kërkohen në çdo moment brenda datës 30 prill 2025.

Kuponët për shpenzim

Kuponët për shpenzim konsistojnë në uljet e përdorura për blerje të biletarisë së tragetit GNV. Pjesëmarrësit mund të përdorin kuponët për shpenzim me arritjen e kufirit të pikëve që tregohen më poshtë:

Kufiri i Pikëve	Çmimet
200 pikë	Kupon për Shpenzim prej 50 €
400 pikë	Kupon për Shpenzim prej 100 €
600 pikë	Kupon për Shpenzim prej 150 €
800 pikë	Kupon për Shpenzim prej 200 €
1000 pikë	Kupon për Shpenzim prej 250 €
1200 pikë	Kupon për Shpenzim prej 300 €
1400 pikë	Kupon për Shpenzim prej 350 €

Bileta e ulur në çmim do të emetohet nga GNV, nëpërmjet kontrollit të disponueshmërisë së vendeve. Bileta do të dërgohet me mail.

La GNV do të japë mundësinë të gjithë pjesëmarrësve që do të kenë mbledhur pikët deri në datë 30/04/2022 në Nismën promovuese të mëparshme të ri-integrojnë pikë të mundshme që kanë akoma në dispozicion. Në veçanti këto pikë do të radhiten me kufijtë e rinj, sipas faktorit të konvertimit që i lejon Pjesëmarrësit të mbajë shumën e Kuponit për shpenzim deri atëherë të maturuar.

Pikët e konvertuara kështu do të përdoren pra deri në datë 30/04/2025.

Kuponi për shpenzim nuk do të aplikohet mbi taksa të mundshme të parashikuara mbi biletë.

Për çdo biletë mund të përdoret vetëm një kupon për shpenzim. Kuponët për shpenzim më lartë të përshkruar nuk janë, pra, të mbledhur midis tyre dhe nuk mund të mbledhen me kuponë për shpenzim të tjerë dhe/ose ulje të kryera nëpërmjet kodit kupon.

Kuponi për shpenzim mund të përdoret për blerjen e biletave edhe me shumë lekësh më të ulët se ajo e vlerës së kuponit për shpenzim të maturuar, në këtë rast kuponit për shpenzim nuk do të japë të drejtën e arritjes së restos së mbetur dhe nuk mund të përdoret për shpenzime të tjera.

Nënkuptohet që Pjesëmarrësi nuk do të ketë të drejtën e ri-kreditimit të pikëve në rast anulimi të biletës me të cilën ai i ka përdorur ato.

Nuk janë parashikuar zgjatje ose ri-emetime të kuponëve për shpenzim që nuk janë përdorur brenda kohëve të treguara.

Kuponi për shpenzim, gjithashtu:

- nuk mund të ndahet në pjesë dhe duhet të përdoret në një përdorim të vetëm;

- nuk mund të kthehet ose të shndërrohet në monedhë;
- është ngushtësisht personale;
- nuk është i transferueshëm në asnjë rast kundrejt pagese ndaj personave të tretë përveç Pjesëmarrësve. Shoqëria Promovuese rezervon të drejtën e kryerjes së kontrolleve të duhura;
- nuk mbledhet me nisma të tjera promovuese të mundshme të shpallura nga GNV, përveç parashikimeve të ndryshme të treguara nga kjo e fundit.

Për të gjitha aspektet që i përkasin biletës dhe transportit i referohet Rregullorja në fuqi e sjellë në “Kushtet e Përgjithshme të Transportit të Pasagjerëve” të GNV.

Trajtimi i të dhënave personale

Në bazë të nenit. 13 të Rregullores Evropiane 2016/679 dhe të D.lgjs. 196/2003, siç modifikohet nga D.lgjs. 101/2018, Grandi Navi Veloci S.p.A., në cilësi të Titullarit të trajtimit, do të trajtojë të dhënat personale të furnizuara nga klienti në momentin e regjistrimit në platformën fidelity card MyGNV në respektin e normativës në fuqi dhe parimeve të korrektesës, ligjshmërisë, transparencës dhe mbrojtjes së konfidencialitetit nga ajo e parashikuar.

Në fushën e aderimit ndaj programit të besnikërisë së MYGNV, trajtimi i të dhënave do të finalizohet ndaj kryerjes së aktiviteteve të renditura me poshtë:

- a) lëshimi i Carta Fedeltà dhe menaxhimi i aktiviteteve që nuk ushtrohen në formë anonime dhe të nevojshme për të lejuar nënshkrueseve përfitimin dhe njohjen e uljeve dhe promovimeve, pjesëmarrjen në mbledhjen e pikëve dhe hyrjen në shërbime të tjera plotësuese të përdorura nëpërmjet Kartës.
- b) kryerjen, mbas pëlqimit të shprehur me shkrim të klientit, të aktiviteteve të marketing që ka të bëjë, me nisjen - nëpërmjet e- mail, SMS dhe MMS ose instrumente jo të automatizuar, si posta letër dhe telefon me operatorë - të materialeve promovuese dhe të komunikimeve që kanë përmbajtje informative dhe/ose promovuese në raport me produkte dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose të Titullarit;
- c) kryerja, mbas pëlqimit të shprehur me shkrim të klientit, të aktivitetit të profilizimit personal ose të bashkuar dhe të kërkimit të tregut që studiojnë, për shembull, analizën e zakoneve dhe zgjedhjeve të konsumit, përpunimit të statistikave mbi to ose vlerësimin e shkallës së kënaqësisë kundrejt produkteve dhe ndaj shërbimeve të propozuara.

Për qëllimet e përshkruara në shkronjën a) të pikës së mëparshme, dhënia e të dhënave është fakultative, por përbën kushtin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për lëshimin e Carta Fedeltà: mungesa e dhënies sjell për kërkuesin pamundësinë e fitimit të Kartës vetë.

Për qëllimet e përshkruara në shkronjat b) dhe c) të pikës së mëparshme, dhënia e të dhënave është fakultative dhe refuzimi i mundshëm i dhënies së këtyre të dhënave dhe dhënia e pëlqimit sjell pamundësinë për Titullarin të fillojë aktivitetet e marketingut drejtpërdrejtë dhe të profilizimit të parashikuar, por nuk ndikon në mundësinë e kërkuesit të fitojë lëshimin e Carta Fedeltà dhe të arrijë përfitimet të lidhur me të.

Trajtimi i të dhënave do të kryhet nga personel në varësi të drejtpërdrejtë të Titullarit dhe/ose nga persona fizik dhe juridik të identifikuar nga ai vetë posaçërisht si përgjegjës ose të ngarkuar për vetë trajtimin. Të dhënat e furnizuara nuk do të jenë në asnjë rast objekt përhapje ose komunikimi ndaj personave të tretë, përveç subjekteve ndaj të cilëve u njihet mundësia e hyrjes në të dhënat nga dispozitat ligjore ose nga urdhër të autoriteteve si dhe subjektet, edhe të jashtëm dhe/ose të huaj, të cilët Titullari i përdor për kryerjen e aktiviteteve instrumentale dhe/ose plotësuese për menaxhimin e Carta Fedeltà dhe emetimin e shërbimeve dhe përfitimeve të lidhur me të, të përfshirë gjithashtu furnizuesit e zgjedhjeve software, web application dhe shërbime të storage të emetuara edhe nëpërmjet sistemeve Cloud Computing dhe të përdorur për këtë qëllim.

Të Dhënat Personale do të ruhen nga Titullari, për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e nismës e megjithatë jo përtej afateve kohorë të parashikuar nga Ligji.

Titullari mund të jetë i detyruar të ruaj të Dhënat Personale të klientit për një periudhë më të gjatë

në përmbushje të një detyrimi ligjor ose kundrejt një urdhër të një autoriteti.

Në përfundim të periudhës së ruajtjes të Dhënave Personale të klientit do të eliminohen. Pra, në fund të këtij afati kohor e drejta e hyrjes, eliminimi, korrigjimi dhe e drejta e zhvendosjes së të Dhënave nuk mund të ushtrohen më. Rregullorja UE 2016/679 u jep të interesuarve të drejtën e parashikuar nga neni. 15 deri te neni. 21 i GDPR, si dhe të drejtën e paraqitjes së një ankese Autoriteteve kompetente në bazë të nenit. 77 i GDPR.

Në veçanti, për sa i përket trajtimit të të dhënave personale të interesuarit kanë të drejtën të kërkojnë GNV, hyrjen, korrigjimin, eliminimin, kufizimin, kundërvënien dhe zhvendosjen; gjithashtu mund të propozojë ankesën, përballë Autoritetit të Kontrollit, që në Itali është Garant për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Të interesuarit mund të dërgojnë një kërkesë formale të ushtrimit të të drejtave të tyre ose një sinjalizim të një mospërmbushje të mundshme ose një shkelje, duke dërguar një e-mail në: dpo@gnv.it.

Specifikohet që informacionet e përgjithshme mbi privacy mund të konsultohet në formë të zgjeruar dhe të azhurnuar në link <https://info.gnv.it/images/pdf/it/privacy.pdf>.

Të Ndryshme dhe të Mundshme

GNV rezervon të drejtën të ndryshojë, edhe pjesërisht në çdo moment, mënyrën e funksionimit dhe pjesëmarrjes në Nismë, duke publikuar këto ndryshime në faqen e internetit www.gnv.it dhe në seksionin web privat që i rezervohet çdo pjesëmarrësi.